



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:079320
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05615857

PA1.nr.921/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.M nga Peja, për shkak të veprës penale Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit nga neni 141 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit L.M av. SH.M të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.311/21 të dt.28.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit L.M, av. SH.M, Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, P.nr.311/21 të dt.28.04.2023, ashtu që të akuzuarit L.M për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, i shqiptohet dënimi me Kusht duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës së verifikimit prej një(1) viti nuk kryen veprë të re penale.

Në pjesët tjera aktgjykimi i ankimuar mbetet i pa prekur.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin, P.nr.311/21 të dt.28.04.2023, të akuzuarin L.M e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit nga neni 141 par.1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burg të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 4 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga pala e dëmtuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit L.M av. SH.M, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës që ankesën ta aprovoi si të bazuar, ndërsa aktgjykimi e ankimuar ta ndryshoj dhe kundër të mbrojturit tim L.M të shqiptoj dënim me të butë.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.958/23 të datës 28.07.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit, L.M av. SH.M e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi dënimin me pretendimet se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin do të duhej të shqiptoj një dënim më të butë, pasi që i pandehuri L.M që nga fillimi i procedurës e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet. Konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimin, nuk ka zbatuar drejtë dispozitat për kushtet e zbutjes së dënimin. Bazuar në faktet se i pandehuri në të gjitha fazat e procedurës, e ka pranuar fajësinë, po ashtu është mbaitës i familjes, pendimi i tij i thellë për veprën e kryer, andaj i propozon gjykatës që të vlerësoj këto rrethana në kuptim të nenit 71 par. pika 1.3 e lidhur me nenin 72 të KPRK-së. I propozon gjykatës së Apelit Gjykata e Apelit e Kosovës që ankesën ta aprovoi si të bazuar, ndërsa aktgjykimi e ankimuar ta ndryshoj dhe kundër të mbrojturit tim L.M të shqiptoj dënim me të butë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësi të të akuzuarit, që të akuzuarit të shqiptohet dënim më i butë, janë të bazuara. Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore, janë të bazuara. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se Gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar rrethanat të cilat

ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ku gjykata e shkallës së parë në rastin konkret nuk ka gjetur fare rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestarë, keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimin të fajësisë dhe kërkim faljen e sinqertë të bërë nga i pandehuri drejtuar të dëmtuarit në gjykatë në seancën e shqyrtimit fillestarë.

Një konstatim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, mirëpo Gjkata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit nuk i ka vlerësuar në shkallën e duhur të gjitha rrethanat lehtësuese të rastit konkret e të cilat rrethana gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar ndërsa nga ana tjetër nuk ka gjetur as edhe një rrethanë rënduese, andaj në këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe pas vlerësimit të tyre, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga kjo gjykatë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutore dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjeneralë, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.921/23, më datë 22.04.2024

Procesmbajtësja,
Gentijana Manaj-Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Abdullah Ahmeti

Ferit Osmani
